

RENDI I DITËS

Projektvendim “ Për pranim për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, të partive politike të depozituara në KOZ”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, V.Baxhini, O.Peto
- **Parti Politike:** PLL, PBK, POSH, PBD,PBKD, PKKA, PBPP, PDRE,
PESH, PLDSH, AMIE, LDN, PDBMSH, PPKDSH

Z.E.Lako: Çelimi sot seancën e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për të verifikuar plotësimin e elementeve të formës dhe të përmbajtjes së kërkesave ankimore me objekt: Kundërshtimin e vendimit nr.430, datë 22.07.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të partive politike për vitin kalendarik 2020 si dhe sanksionet për mosdorëzimin e tyre. Në zbatim dhe të vendimit nr.109, datë 26.07.2021 të KAS-it, i cili vendosi pranimet për shqyrtim të kërkesave ankimore nr.62, datë 26.07.2021 dhe pezullimin e shqyrtimit administrativ deri në përfundim të afatit të ankimit treditor, të vendimit nr.430 datë 22.07.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në përfundim të afatit të ankimit, të gjitha partitë politike u njoftuan nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për riçeljen e shqyrtimit administrativ për të gjitha kërkesat ankimore nga numri 63 deri në kërkesën me nr.73, me të njëjtin objekt.

*Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.09.2021**

Po i citoj, në mënyrë që në qoftë se kemi ndonjë kërkesë ose ndonjë subjekt, i cili nuk është përmendur:

kërkesa ankimore nr.63, Partia Lëvizja e Legalitetit;

kërkesa ankimore nr.64, Partia Balli Kombëtar, Partia Ora e Shqipërisë, Partia Bashkimi Demokrat, Partia Balli Kombëtar Demokrat, Partia Kombëtare Konservatore Albania, Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve, Partia Demokracia e Re Europiane, Partia Emigracioni Shqiptar, Partia Lëvizja Demokratike e Shqipërisë;

kërkesa ankimore 65, Partia Aleanca Maqedonase për Integrimin Europian;

kërkesa Ankimore 66, Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim;

kërkesa ankimore 67, Partia Demokratike e Bashkimit Mysliman Shqiptar;

kërkesa ankimore 68, Partia e Gjellbër;

kërkesa ankimore 69, Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen;

kërkesa ankimore 70, Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar;

kërkesa ankimore 71, Partia Bindja Demokratike;

kërkesa ankimore 72, Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë;

kërkesa ankimore 73, Partia e Unitetit Kombëtar.

Relatori i kësaj seance jam zgjedhur unë Elvin Lako sipas shortit të hedhur në datën 23 korrik 2021, bazuar në nenin 129, të Kodit Zgjedhor. Të pranishëm në seancë janë anëtarët e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, sekretari i Përgjithshëm dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Përsa i përket subjekteve ankuese, shkurtimisht secili nga ju sipas radhës së kërkesave ankimore, shkurtimisht ju lutem, edhe për të verifikuar prezencën dhe aktin e përfaqësimit për secilin subjekt ankues. Duke filluar nga kërkesa 63, Partia Lëvizja e Legalitetit!

**Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.09.2021*

Z.M.Marku, përfaqësues i PLL-së: Zoti Meti Marku, përfaqësues i Partisë Lëvizja e Legalitetit

Z.E.Lako: Jeni vetëm për një subjekt?

Z.M.Marku, përfaqësues i PLL-së: Po, vetëm për një subjekt!

Z.E.Lako: E keni dorëzuar autorizimin? Është përfaqësues ligjor pranë KQZ-së i subjektit. Për kërkesën ankimore nr.64, meqë janë të listuara disa parti, janë përfaqësuar nga një person besoj? Partia Balli Kombëtar, Partia Ora e Shqipërisë, Partia Bashkimi Demokrat, Partia Balli Kombëtar Demokrat, Partia Kombëtare Konservatore Albania, Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve, Partia Demokracia e Re Europiane, Partia Emigracioni Shqiptar, Partia Lëvizja Demokratike e Shqipërisë? Kush është personi që përfaqëson? E keni autorizimin? Ju lutem emrin që ta referoj!

Z.Y.Valteri: Ylber Valteri.

Z.E.Lako: Kërkesa ankimore nr.65, Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European.

Z.E.Fetahu, përfaqësues i AMIE-së: Përshëndetje! Endrit Fetahu, jam i autorizuar nga kryetari i Aleancës.

Z.E.Lako: E keni depozituar?

Z.E.Fetahu, përfaqësues i AMIE-së: E kam depozituar!

*Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.09.2021*

Z.E.Lako: Kërkesa 66, Lëvizja Demokratike për Ndryshim. Po, zoti Murrizi.

Kërkesa 67, Partia Demokratike e Bashkimit Mysliman Shqiptar. Mund ta dorëzoni aty tek sekretaria.

Kërkesa ankimore nr.68, Partia e Gjelbër, nuk është prezent.

Kërkesa ankimore nr.69, Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen, nuk është prezent.

Kërkesa ankimore nr.70, Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, nuk është prezent.

Kërkesa ankimore nr.71, Bindja Demokratike, nuk është prezent.

Kërkesa ankimore nr.72, Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë?

Znj.Z.Prela, përfaqësuese e PPKDSh-së: Zana Prela

Z.E.Lako: Keni autorizim, apo jeni përfaqësuese?

Znj.Z.Prela, përfaqësuese e PPKDSh-së: Ankimimi është bërë në emrin tim. Jam sekretarja e Përgjithshme dhe kryetare e komanduar, ngaqë kryetari ka dhënë dorëheqjen.

Z.E.Lako: Faleminderit! Kërkesa ankimore nr.73, Partia e Unitetit Kombëtar? Nuk ka përfaqësues. Atëherë meqë jemi në seancën e verifikimit të elementeve të formës dhe të përmbajtjes do të vazhdojmë dhe në mungesë të atyre subjekteve që nuk kanë përfaqësues. Ftojme sekretarin e Përgjithshëm të thotë diçka rreth plotësimit të elementeve të formës dhe të përmbajtjes për secilën nga kërkesat ankimore që po shqyrtojmë sot.

**Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.08.09.2021

Z.Y.Merkaj: Atëherë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim nr.430, datë 22 korrik 2021 ka vendosur marrjen e masave administrative me gjobë, në masën 1 milion lekë, për 106 parti politike dhe marrjen e masës administrative gjobë, 50 mijë lekë për 4 parti politike.

Përfaqësuesit e partive politike: Të vjetra apo të reja?

Z.Y.Merkaj: 1 milion lekë janë të vjetra dhe 500 mijë lekë të vjetra. Është vendimi, është i shënuar vendimi,

Z.E.Lako: Flasim me të reja se me të vjetra, nuk flitet!

Z.M.Marku, përfaqësues i PLL-së: (nuk dëgjohet)

Z.Y.Merkaj: Atëherë më fal, 100 mijë lekë dhe 50 mijë lekë.

Z.M.Marku, përfaqësues i PLL-së: Ne po flasim këtë, atje është e shkruar siç e ke shkruar ti (nuk dëgjohet)

Z.E.Lako: Mirë, do t'ju vijë radha dhe mund të bëni në qoftë se keni kontestime. Vazhdojmë zoti sekretar i Përgjithshëm!

Z.Y.Merkaj: Atëherë vendimi është shumë në rregull, u shpreha unë gabim. Vendimi e ka 100 mijë lekë dhe 50 mijë lekë. U shpreha unë gabim. Vendimi është në rregull i shkruar.

Z.E.Lako: Zoti sekretar të referohemi mbi objektin, vazhdojmë ju lutem!

Zbardhi materialin audio

Merita Dulaku

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.09.2021*

Z.Y.Merkaj: Ky vendim iu dërgua për njoftim 110 partive, të cilat kishin marrë masën administrative të gjobës, nga të cilat për 90 parti njoftimet janë kthyer në adresë të pasaktë dhe 20 parti kanë marrë njoftimin. Nga këto 20 parti, të gjitha kanë bërë ankim ashtu siç i regjistruat edhe juve. Nga një verifikim paraprak i kërkesës ankimore të 19 kërkesave ankimore konstatohet se plotësohen elementet e formës dhe përmbajtjes, kundër vendimit nr.430 të datës 22 korrik 2021. Bazuar në nenin 130, të Kodit Zgjedhor, duke qenë se kompetencë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ku është KAS-i, për shqyrtimin e kërkesave ankimore, të gjitha kërkesat i janë drejtuar KAS-it, gjithashtu legjitimimi i ankuesve pasi janë të gjitha partitë që kanë marrë gjobë dhe kanë interes të ligjshëm për të kundërshtuar këtë vendim, gjithashtu kanë respektuar dhe afatin ligjor të ankimit, të vendosur me vendim nr.430, brenda 3 ditësh është paraqitur ankimi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kundër këtij vendimi. Kështu që, administrata propozon që të kalojnë të gjitha për shqyrtim, pasi plotësojnë elementet e formës dhe të përmbajtjes, të nenit 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor. Faleminderit!

Z.E.Lako: Faleminderit zoti sekretar i Përgjithshëm! Atëherë, ashtu siç tha dhe zoti sekretar i Përgjithshëm, seanca sot ka të bëjë me përmbushjen e kriterëve formale të ankimit, mbi formën e ankimit dhe kompetencën e KAS-it për shqyrtimin e ankimit dhe respektimin e afatit ligjor për bërjen e këtij ankimi. Pra nuk do shqyrtojmë sot përmbajtjen, atë që ka objekti i ankimit, kështu që duhet shkurtimisht nëse dikush nga ju dëshiron të thotë diçka, vetëm mbi këtë, mbi respektimin e formës së bërjes së ankimit, elementet formale, ato që duhen plotësuar nga Kodi Zgjedhor, pra është sipas formës apo jo, ku zoti sekretari i Përgjithshëm, sipas administratës, të gjitha ankimet janë në formën e kërkuar nga ligji, të paktën atë do ta konstatojmë dhe ne si KAS, por ky është propozimi që

*Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.09.2021**

vjen nga administrata. Tani, përsa i përket, vetëm për këtë, jo për shkaqet e ankimit, që pse është vendosur gjoba, cilat janë shkaqet që ju mendoni që nuk keni pse të gjobiteni dhe pse KAS-i duhet të marrë një vendim pro jush, kjo do jetë në seancën e ditës së nesërme. Sot flitet vetëm për këtë. Nëse dikush nga ju dëshiron të thotë diçka, është i lutur ta bëjë tani!

Z. Y.Valteri, përfaqësues i PBD-së: Përveç kësaj që besoj se u sqarua, unë kam qenë prezent atë ditë kur është marrë vendimi nga KQZ-ja dhe më bëri përshtypje kjo gjoba 1 milion lekë, se është e shkruar. 1 milion lekë vendosi të gjobisë partitë politike që s'kanë dorëzuar pasqyrat financiare me gjobë 1 milion lekë. Kurse ligji për partitë politike për mosdorëzimin e pasqyrave periodike financiare deri më 31 mars e ka nga 50 mijë deri në 100 mijë lekë. Kjo u sqarua.

Z.E.Lako: Do t'i sqarojmë në seancën e ditës së nesërme të gjitha këto! Ndonjë gjë për ankimin që keni bërë secili nga ju, pavarësisht se administrata ka referuar që të gjithë ankimet janë bërë në konform të ligjit. Keni ndonjë gjë? Nuk keni. Po zoti Murrizi!

Z.M.Murrizi, Përfaqësues i LDN-së: Në fakt unë kam ardhur sot me idenë që do të bëhet diskutimi, trajtimi i çështjes në themel, jo vetëm për kërkesat paraprake, nisur nga fakti që subjekti politik që unë drejtoj është regjistruar në gjykatë në datën 19 tetor 2020, vendimin e argumentuar të regjistrimit të gjykatës, e kam marrë në dhjetor 2020 edhe në lidhje me procedurat tatimore, që subjektet që regjistrohen 3 muajt e fundit në QKR, nuk paraqesin bilanc tatimor janar/mars të vitit pasardhës, me ligjin tatimor. U habita shumë kur pashë vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që gjobiti një subjekt politik. Bile në KQZ është regjistruar në janar të 2021 dhe kërkuat bilanc për 2020-ën.

**Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.09.2021*

Z.E.Lako: Patjetër zoti Murrizi, do të keni të drejtën tuaj në seancën e ditës së nesërme për t'i sqaruar këto prapësimet tuaja në lidhje me vendimin e Komisionerit. Po zoti Gjuzi, në qoftë se keni diçka mbi formën dhe elementet që po themi?

Z.K.Gjuzi, përfaqësues i PKKA-së: (Nuk dëgjohet)

Z.E.Lako: Një sqarim! Administrata ka propozuar që të gjitha ankimet i plotësojnë elementet e formës dhe të përmbajtjes, ne do të marim vendim pas pak.

Z.Y.Merkaj: Mund të bëj një sqarim të thjeshtë? Të gjitha vendimet që po shikoj që kanë përfaqësuesit e partive janë, është projektvendimi që kemi pasur, por vendimi nr.430 e ka 100 mijë lekë dhe 50 mijë lekë.

Z.E.Lako: E qartë! E kemi përpara dhe ne.

Z.Y.Merkaj: Dhe nuk janë ato vendime, i referohem vendimeve që nuk janë vendime, janë projektvendime.

Z.E.Lako: Është e sqaruar sepse vendimin e kemi të gjithë, është e publikuar, është 100 mijë lekë. Mund t'i referohen ndonjë shifre që mund të jetë thënë në atë seancë, kur është shpallur vendimi, nuk e di. Do ta sqarojmë ditën e nesërme. Po zoti Gjuzi! Zoti Gjuzi mund të ketë dhe një ngatërrësë nga ndonjë media dhe mund të jetë ndonjë lajm që, kjo është sqaruar tani, kështu që besoj...

Z.K.Gjuzi, përfaqësues i PKKA-së:(Nuk dëgjohet)

*Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.09.2021*

Z.E.Lako: Do t'i sqarojmë nesër i nderuar, kështu që ju lutem të vazhdojmë me këtë pjesë që të mos vonohemi dhe ne, dhe ju, derisa nesër do të bëjmë të njëjtën gjë. Nga anëtarët e KAS-it ka ndonjë pyetje?

Z.L.Braho: Thjesht kisha një, meqenëse u sqarua sot, kishte paqartësi nga disa nga ankimuesit në lidhje me vlerën e gjobës, që gjoba nuk është më 1 milion po është 100 mijë apo 50 mijë, në qoftë se ndonjëri do të tërhiqet nga ankimi, mund ta bëjë. Pra në qoftë se e pranon shkeljen dhe vlera e gjobës është ajo e parashikuar nga ligji, mund të tërhiqeni nga ankimi.

Z.E.Lako: Po zoti Gjuzi!

Z.K.Gjuzi, përfaqësues i PKKA-së: (nuk dëgjohet) të merret një vendim që të përgjysmohen gjobat, mos të jenë në (nuk dëgjohet) edhe komisioni dhe pjesa jonë.

Z.E.Lako: Mirë, faleminderit! Shqyrtimin në themel do ta bëjmë nesër, të ankimit kështu që përgjysmimi, ikja apo lënia do të ketë të bëjë me seancën e nesërme.

Znj.Z.Prela, përfaqësuese e PPKDSh-së: A mundem? Zana Prela, sekretare e Përgjithshme, në fakt sekretare e Përgjithshme nuk kam shumë që jam edhe kryetari ka dhënë dorëheqjen pa justifikim, bashkohem me mendimet e kolegëve dhe tek kjo që të paktën të penalizohemi në një mënyrë më të butë, pasi nuk kemi marrë pjesë as në zgjedhje, as njoftimi. Ta bëjmë përgjysmë, të jemi pak dhe njerëz, se kemi nevojë.

*Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 08.09.2021*

Z.E.Lako: Faleminderit! Do t'i shqyrtojmë nesër. Nga anëtarët e KAS-it ka ndonjë pyetje tjetër? Jo! Atëherë KAS do tërhiqet për vendim.

Rifillon Mbledhja

Ora 13:23

Atëherë, KAS i konsultuar në vend vendosi që të gjitha ankesat t'i kalojë për shqyrtim. Të gjitha ankesat siç janë bërë. Seancën e radhës do ta lëmë nesër në orën 10:00, datë 09 shtator. Faleminderit!

Vendimi nr. 110

**Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku**



09.09.2021

Ora 10:11

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, të partive politike, të depozituara në KQZ”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI, Z.Ledio BRAHO.
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, V.Baxhini, O.Peto
- **Parti Politike:** ADK, P.B.K, P.O.Sh, PBD, PBKD, PKKA, PBPPSH, PDRE, PESH, MEGA, PLDSH, PLDN, PDBM, BD

Z. E.Lako: Atëherë deklaroj të çelur seancën e sotme me objekt “Shqyrtimin e ankimit nr. 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 430, datë 22. 07. 2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të partive politike, për vitin kalendarik 2020, si dhe sanksionet për mosdorëzimin e tyre”. Në total kanë ushtruar të drejtën e ankimit 20 subjekte zgjedhore kundër këtij vendimi dhe po i referoj si më poshtë. Që të mos përsërisim, ju lutem kur të referoj ankimin, kush është përfaqësuesi, të thotë emrin. Atëherë, kërkesa ankimore nr. 62, Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë.

Përfaqësuesi i ADK-së: Pa mikrofon, nuk dëgjohet.

Z. E.Lako: Je i regjistruar, thjesht referoni emrin.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

Përfaqësuesi i ADK-së: Pa mikrofon, nuk dëgjohet.

Z.E.Lako: Atëherë, kërkesa ankimore nr. 63, Partia Lëvizja e Legalitetit, në mungesë. Kërkesa ankimore nr. 64, janë disa parti, Partia Balli Kombëtar, Partia Ora e Shqipërisë, Partia Bashkimi Demokrat, Partia Balli Kombëtar Demokrat, Partia Kombëtare Konservatore Albania, Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar, Partia Demokracia e Re Europiane, Partia Emigracioni Shqiptar, Partia Lëvizja Demokratike e Shqipërisë. Përfaqësuar nga...

Z.Y.Valteri, Kryetar i PBD-së: Ylber Valteri, jemi regjistruar që dje.

Z.E.Lako: Kërkesa ankimore nr. 65, Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim European, në mungesë. Kërkesa ankimore nr. 66, Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim.

Përfaqësuesja e PLDN-së: Jam me autorizim nga kryetari i PLDN-së, zoti Nikolin Saka, që për arsye se ndodhet jashtë vendit, e ka të pamundur të jetë këtu. Kam një autorizim...

Z.E.Lako: Dorëzoja sekretarisë. Kërkesa ankimore nr. 67, Partia Demokratike e Bashkimit Mysliman Shqiptar... (*nuk dëgjohet*). Kërkesa ankimore nr. 68 Partia e Gjelbër, në mungesë. Kërkesa ankimore nr. 69, Partia e Minoritetit Etnik Grek për të Ardhmen.

Z.Th.Miço, Përfaqësues i MEGA: Pa mikrofon, nuk dëgjohet.

***Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

Z.E.Lako: Thoma Miço. Kërkesa ankimore nr. 70, Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, në mungesë. Kërkesa ankimore nr. 71, Partia Bindja Demokratike.

Z.F.Halili, përfaqësues i BD-së: Florjan Halili.

Z.E.Lako: Kërkesa ankimore nr. 72, Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë, në mungesë. Kërkesa ankimore nr. 73, Partia Uniteti Kombëtar, në mungesë. Relator i kësaj seance jam zgjedhur unë, Elvin Lako, sipas shortit të hedhur në datën 23 korrik 2021. Në seancën e djeshme, pra të datës 08.09.2021 u vendos kalimi për shqyrtim i të gjitha kërkesave ankimore. Përpara se të fillojmë me shqyrtimin e çështjes, referoj se janë të pranishëm 4 anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, sekretari i Përgjithshëm dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Për palët që janë në mungesë, në mbështetje të pikës 4 të nenit 135 të Kodit Zgjedhor, do të vazhdojë në mungesë shqyrtimi i ankimit. Ka ndonjë pyetje, ndonjë kërkesë nga palët për përjashtimin e anëtarëve të KAS-it për konflikt interesi apo ndonjë kërkesë të kësaj natyre? Jo, nuk ka! Nga vetë anëtarët për ndonjë konflikt, nuk ka. Atëherë, meqenëse nuk kemi ndonjë kërkesë paraprake vazhdojmë me shqyrtimin e themelit të çështjes. Ftojme sekretarin e Përgjithshëm të na referojë shkurtimisht në lidhje me pretendimet kryesore të ankuesve, në mënyrë që mos të zgjatemi shumë. Nëse kemi ndonjë grupim të këtyre kërkesave sipas objektit, sipas asaj ç'ka ata pretendojnë nëse mundemi, nëse jo pastaj i referojmë për secilën, siç janë bërë ankimet.

Z.Y.Merkaj: Atëherë me vendimin nr. 430, datë 22.07.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur masën administrative, gjobë në masën 100.000 (njëqind

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

mijë) lekë për 106 parti politike, të cilat nuk kanë dorëzuar raportin vjetor për vitin kalendarik 2020. Ka vendosur marrjen e masës administrative gjobë në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për 4 parti politike, të cilat kanë dorëzuar raportin vjetor financiar për vitin 2020, jashtë afatit të përcaktuar në vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kundër këtij vendimi, duke mos qenë dakord, kanë bërë ankim 20 parti politike, të cilat kanë marrë dhe njoftimin, pasi partitë e tjera politike, të cilat kanë qenë bashkëlidhur këtij vendimi i janë kthyer njoftimet me adresë të panjohur, pasi adresa ka qenë e pasaktë, siç është deklaruar nga përfaqësuesit e këtyre partive politike. Nga një shqyrtim paraprak i ankesave, duhet t'i ndajmë në 4 tipologji të ndryshme, për shembull, Partia e Minoritetit Grek për të Ardhmen, pretendon se e ka dorëzuar raportin financiar me postë brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Partia Lëvizja e Legalitetit pretendon se e ka dorëzuar raportin financiar me vonesë pasi ka patur një keqkuptim, të krijuar nga shtyrja e afatit për në shtator me vitin pandemik të 2019-ës. Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar dhe Partia Bindja Demokratike pretendojnë se nuk e kanë respektuar këtë afat pasi janë regjistruar në gjykatë në një afat shumë të shkurtër në vitin 2019. Në vitin 2019 është regjistruar Bindja Demokratike dhe partia tjetër është regjistruar në vitin 2020. Partia Demokratike Bashkimi Mysliman Shqiptar pretendon se ka patur përplasje për kompetencat, pasi nuk kanë patur kryetar dhe pretendon se ka përplasje midis ligjeve dhe prandaj nuk e ka dorëzuar sepse nuk e ka kuptuar afatin kur duhet të dorëzojë. Këto ishin pak a shumë tipologjitë e ankimeve që janë bërë në mënyrë të përmbledhur (*nuk dëgjohet*) të partive politike. Për më tepër mund të shpjegojë secila parti ankesat e saj, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

 4

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 09.09.2021*

Z.E.Lako: Faleminderit zoti sekretar! Shkurtimisht do ju lutesha tani që e keni fjalën ju, në bazë të renditjes së kërkesave ankimore. Nëse harrojmë diçka, nëse do të keni diçka për të shtuar në përfundim mund ta bëni, kështu që do ju lutesha në bazë të renditjes që unë referova më parë dhe do i përsëris tani shkurtimisht. Mbi ç'bazë ju e keni bërë këtë kërkesë? Në bazë të ligjit dhe në bazë të provave eventuale që mund të keni për çdo rast. Pra mund të fillojmë me kërkesën ankimore nr. 62, Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë.

Përfaqësuesi i ADK-së: I nderuar zoti kryetar, lidhur me këtë pikë, për mosdeklarim, të mosdorëzimit të pasqyrave financiare, duhet të theksojmë se kanë qenë disa arsye objektive lidhur me mosdorëzimin e këtyre pasqyrave. Njëkohësisht me sa kemi dijeni, sipas të dhënave që kemi, është dhe një shtyrje afati deri në shtator për dorëzimin e këtyre pasqyrave. Njëkohësisht pika kryesore që ka qenë lidhur me mosdorëzimin, ka qenë pandemia. Shkaqe të cilat janë të pavarura nga ne nga vetë ligji në kuptimin e saj dhe si e tillë ne kërkojmë heqjen e kësaj gjobe, pasi është një shkak i arsyeshem dhe objektiv që duhet të mbështetet, që e parashikon edhe ligji. Me shkaqe objektive të njohura botërisht dhe ligjërisht mund të bjerë ky shkak, duke patur parasysh heqjen e kësaj gjobe dhe pikërisht i referohem edhe ankimit nga ana jonë. Kjo është pika që duhet të merret parasysh për këtë vendim, duke ndryshuar vendimin dhe heqjen e gjobës për masën, pasi çfarëdolloj detyrimi që do të kishim, është diçka që nuk i humbet për t'i kryer detyrimet, pavarësisht nga periudha apo koha që nuk është kryer. Në këtë ditë ne kërkojmë heqjen e kësaj gjobe, siç është referuar edhe ankimi. Kemi bërë edhe aplikimin në datë 23 korrik, për të bërë aplikimin në këtë pikë. Në këto kushte ne kërkojmë heqjen e gjobës.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

Z. E.Lako: Faleminderit, pyetjet eventuale që mund të këni ju ose anëtarët e KAS-it do i bëjmë në përfundim të referimit për secilin ankim. Të bëjmë një rregull që mos të zgjatemi shumë. Atëherë, vazhdojmë me Partia Lëvizja e Legalitetit, Kërkesa nr. 63 kishte përfaqësues? Jo, atëherë vazhdojmë i qëndrojmë atyre që kanë parashikuar dhe kanë shpjeguar në kërkesat ankimore. Për ata që janë në mungesë do i referohemi çfarë ata kanë paraqitur me shkrim në kërkesën ankimore. Për kërkesën ankimore nr. 64 që besoj e ka një përfaqësues, Partia Balli Kombëtar, Partia Ora e Shqipërisë e kështu me rradhë.

Z.Y.Valteri, përfaqësues i PBD-së: Faleminderit! Atëherë, neni 23 i ligjit 80, i ndryshuar, detyron partitë politike që në mënyrë periodike, çdo vit të dorëzojnë pasqyrat financiare për vitin paraardhës deri në datën 31 mars. Ne e kemi parashtruar dhe në ankesën që kemi bërë. Ne kemi qenë korrektë. Të gjitha ne partitë që kemi bërë në grup një ankim për gjobën që na është vënë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe siç e tha dhe kolegu, në vitin 2019, si vit pandemie që ishte, këto pasqyra u shtynë që të dorëzohen deri në datë 30 shtator. Edhe sivjet nuk ka qenë një vit normal, besoj këtë e dinë të gjithë. Për të gjithë institucionet e shtetit, jo vetëm për ne si parti politike, dhe ne kemi kujtuar që edhe sivjet data e dorëzimit do të jetë 30 shtatori. Pra, ne nuk i kemi lënë pa dorëzuar pasqyrat financiare, për t'iu fshehur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që të na kontrollojë me kontabilistët e saj, por ka qenë një keqkuptim që ne e dimin që dhe sivjet do të ishte data 30 shtator. E dyta, ne ato pasqyra financiare i kemi dorëzuar, janë aty, pavarësisht se sekretari nuk e tha... aty janë pasqyrat financiare. Ju kur të doni mund t'i kontrolloni. Unë besoj që ne nuk i bëjmë asnjë dëm buxhetit të shtetit, pra dëmi për ne partitë politike për këto vonesa që kemi bërë në një vit jo normal, dëmi në buxhetin e shtetit është 0 lekë. Kërkoj mirëkuptimin tuaj ta vlerësoni edhe këtë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*


Dt. 09.09.2021

pikë. Pika tjetër është që ne jo se justifikohemi, por ne nuk marrim asnjë lek. Nuk besoj se këto 20 parti që kanë bërë ankim, që kanë një administratë partie, që të kenë një financier të përhershëm, me pagesë e të gjitha, që të jetë gati në çdo moment. Justifikimi kryesor është që ne nuk e kemi ditur që edhe sivjet nuk do të jetë 30 shtatori, për të dorëzuar këto pasqyra financiare. Mos të zgjatem se do të flasim edhe kolegët, unë kërkoj mirëkuptimin tuaj që ta vlerësoni këtë dhe të na e falni këtë gjorbë që ka vënë Komisioni Qendror, faleminderit.

Z.E.Lako: Faleminderit edhe ju! Vazhdojmë me kërkesën ankimore nr. 65, Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian. Është në mungesë, kështu që i qëndron atyre që janë shpjeguar në kërkesën ankimore. Kërkesa ankimore nr. 66, Lëvizja Demokratike për Ndryshim.

Përfaqësuesja e PLDN-së: Edhe Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim, i qëndron shkaqeve të parashtruara në kërkesën ankimore nr. 66. Le të themi që, ashtu siç thanë edhe përfaqësuesit e subjekteve të tjera politike, edhe ky subjekt ka qenë gjithmonë i rregullt në dorëzimin e pasqyrave financiare, ashtu siç e parashikon ligji për partitë politike. Në konfuzionin e afateve të krijuara që në vitin e kaluar me fillimin e pandemisë, ku afatet gjatë gjithë kohës janë shtyrë, pikërisht për të mos penalizuar subjektet për shkak të një situatë të rënduar. Fakti që edhe vetë kryetari i partisë është ndodhur jashtë vendit dhe kjo e ka bërë edhe më të vështirë që ai të angazhohet për përmbushjen e këtij detyrimi, i bindur që afati do të shtyhej, kjo ka bërë që të neglizhojë në dorëzimin e pasqyrave financiare, duke menduar se afati final do të ishte 30 shtatori, referuar kjo edhe eksperiencës së një viti më parë. Kështu që shpresojmë që kërkesa e subjektit të merret parasysht dhe ky vendim i Komisionerit të ndryshohet, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

7


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

Z.E.Lako: Faleminderit dhe ju! Vazhdojmë me Kërkesën Ankimore nr. 67. Partia Demokratike e Bashkimit Mysliman Shqiptar.

Z.M.Ndoi, përfaqësuesi i PDBM-së: I nderuar zoti kryetar, zotërinj anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe të Sanksioneve, Partia Demokratike e Bashkimit Mysliman Shqiptar nuk ka rritur dot të ketë një bilanc financiar siç e parashikon ligji për partitë politike deri në 31 mars, për shkak se brenda kësaj partie është krijuar, diku nga janari, një konflikt për postin e kryetarit, përgjithësisht për lidhshirin. Duke qenë se kam qenë në zyrë me një avokat, i cili ishte pjesë e strukturave. Zotëria ka marrë dokumentacionin dhe ka dashur t'i marrë edhe partitë. Zoti Osman Mema që ka qenë themeluesi i kësaj partie dhe njëkohësisht kryetar deri në atë kohë. Zotëria duke qenë në një moshë të thyer, diku tek 83-84 vjeç, diku tek 70-75 kur e ka themeluar atë parti, ka qenë i pamundur të orientohet në të gjithë këtë situatë dhe lëre pastaj për t'u marrë me bilance, pasi i gjithë dokumentacioni i të ardhurave, i shpenzimeve, të gjitha ishin marrë nga avokati, i cili nuk ka denjuar t'ia drejtojë. Më së fundi ai ka arritur të marrë diçka nga ajo, por ka qenë shumë vonë për të referuar një bilanc dhe për të qenë korrekt me ligjin. Përpos të tjerave, kjo forcë politike thuhet se është inekzistente po ta marrësh nga pikëpamja financiare sepse vetëm me paratë e atij zotërie mbahet. Asnjë e ardhur tjetër nuk rezulton. Fakti që ajo parti është regjistruar në zgjedhje vetëm një herë në vitin 2009 dhe më pas ka pushuar së ekzistuari. De fakto ka pushuar së ekzistuari, thjesht de juro, e gjithë partia ekziston me një statut, një program dhe një Osman Mema. E gjitha kjo e bën të pamundur që zotëria të ketë para për të paguar kontabilist, për të paguar drejtues partie, për t'u marrë me gjithë pjesën. Ne gjykojmë që përpos kësaj edhe pandemia, shtoi edhe pjesën tjetër, të themi këto

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

anomalitë për shtyrje afatesh, që më shumë vijnë nëpërmjet gazetash dhe krijojnë një lloj situatë konfuze. Zotëria nuk është orientuar dot sepse ka qenë shumë e vështirë, madje edhe për parti që janë goxha të organizuara mirë, jo më për Partinë Demokratike të Bashkimit Mysliman Shqiptar. Ne ju kërkojmë të shfuqizohet kjo gjobë, për arsyet që përmenda, por edhe për shkaqe të tjera që janë në pamundësinë e tij, madje edhe në paditurinë e saj për t'u marrë me këto. Kaq kisha.

Z. E. Lako: Faleminderit! Kërkesa ankimore nr. 68, Partia e Gjelbër, në mungesë i qëndron kërkimeve që ka bërë në kërkesën ankimore. Kërkesa ankimore nr. 69, Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen.

Z.Th.Miço, Përfaqësues i MEGA: Po, të nderuar anëtarë të Komisionit, Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen e konteston këtë vendim për arsye se pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afatit dhe nuk e di në qoftë se në dosje kjo shkresë nuk është vlerësuar. Ne kemi dërguar shkresën ose vërtetimin nga filiali i postës Sarandë. Që në datën 31, ora 14:43, është dorëzuar pra në postën e Sarandës. Kjo sigurisht pas gjurmimit që i kemi bërë në datën 1 është nisur dhe në datën 2 është marrë nga Komisioni. Ne jemi brenda afatit. Në datën 31 në darkë mbaronte afati, në 12 ne e kemi dorëzuar, pavarësisht se si është vepruar në raste të tjera. Është një afat që posta ose elektronika duhet ta regjistrojë si një afat të genësishëm, pra brenda afatit. Prandaj them që duhet vlerësuar kjo dhe Partia e Minoritetit Grek duhet të kundërshtonte këtë masë, për arsye se e ka dorëzuar këtë pasqyrë brenda afatit. Mendoj se duhet marrë parasysh nga Komisioni se mbase në dosje kanë qenë shkresat, por nuk janë parë me vëmendje, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*


9


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

Z.E.Lako: Faleminderit! Vazhdojmë me kërkesën ankimore nr. 70, Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, në mungesë i qëndron kërtimeve që ka bërë në kërkesën ankimore. Kërkesa ankimore nr. 71, Partia Bindja Demokratike.

Z.F.Halili, përfaqësues i BD-së: I nderuar kryetar, të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, për t'i rënë shkurt kalojmë direkt tek argumenti bazë, ku kemi përgatitur mbrojtjen në lidhje me vendimin 430 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në vendimin e tij është bazuar në vendimin e KQZ-së, nr. 14, datë 23.11. 2012 “Për disa shtesa edhe ndryshime në vendimin nr. 3, datë 18.01.2012, për miratimin e rregullave, për formatet e standartizuara, për raportet financiare të partive politike dhe raportimet e kontrollit financiar nga ekspertë kontabël”. Ne e kundërshtojmë këtë vendim si të pabazuar në ligj dhe në fakte sepse në të vërtetë ligji për partitë politike kërkon hartimin e një raporti financiar të çdo viti kalendarik nga partia politike, por ligji nuk e ka përcaktuar një afat kohor të dorëzimit të një raporti, sepse në vendimin nr. 14, datë 23.11.2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 3, datë 18.01.2012”, në lidhjen 2 të vendimit nr. 3, datë 18.01.2012 bëhen këto ndryshime. Para pikës 1 i shtohet pika 01 me këtë përmbajtje “Partitë politike duhet të dorëzojnë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve raportin financiar brenda datës 31.03.2012”. Siç evidentohet qartë nga kjo përmbajtje e dispozitës ku është bazuar Komisioneri për të përlogaritur afatin kohor, ky afat kohor i referohet vetëm vitit kalendarik 2012. Nuk i referohet vitit kalendarik 2020, në vendimin në të cilin është bazuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Për këtë arsye, sipas mendimit tonë, ky vendim, vendimi nr. 430 i vitit 2021, i Komisionerit është i paligjshëm sepse siç rezulton nga kuadri ligjor, ligji nuk ka përcaktuar një afat për dorëzimin e këtyre raporteve vjetore. Në këto kushte nuk

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.09.09.2021

është i lidhur as si detyrim për dorëzimin e këtyre raporteve brenda një afati të përcaktuar. Kjo është arsyeja që nga viti 2012 dhe deri më sot Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka aplikuar asnjëherë asnjë sanksion të lidhur me afatin e dorëzimit të raporteve financiare. Në përfundim kërkojmë nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve prishjen e vendimit të Komisionerit nr. 430, 2021, faleminderit.

Z.E.Lako: Faleminderit edhe ju! Vazhdojmë me kërkesën ankimore nr. 72, Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë, në mungesë u qëndron kërtimeve që ka bërë në kërkesën ankimore. Kërkesa ankimore nr. 73, Partia e Unitetit Kombëtar, në mungesë gjithashtu u qëndron kërkesave që ka bërë në kërkesën ankimore. Atëherë, mbaruam me palët ankuese. Anëtarët e KAS-it nëse kanë pyetje. Ju zoti Rusmali, po!

Z.I.Rusmali: Unë fillimisht do të doja disa përgjigje nga administrata. Na sqaroni me cilin akt... u përmend këtu nga palët ankuese, me cilin akt është bërë shtyrja e afatit për në shtator vitin e kaluar, për raportimin e vitit 2019. Ka akt për këtë? Si është realizuar shtyrja?

Z.Y.Merkaj: Jo, në dijeninë time nuk ka asnjë akt që është shtyrë nga KQZ-ja. Nuk ka akt.

Z.I.Rusmali: Pra nuk është e vërtetë që vitin e kaluar është shtyrë për në shtator?

Z.Y.Merkaj: Jo, nuk është e vërtetë.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

Përfaqësues të partive politike: Pa mikrofon, nuk dëgjohet.

Z.I.Rusmali: Të lutem të mbaroj pyetjet unë pastaj... ti do e kesh mundësinë ta thuash këtë gjë. Shkresën nuk e ke me vete. Po munde ta marrësh është mirë ta marrësh, por nuk ka rëndësi sepse ti do e kesh mundësinë ta thuash. Sot që jemi në këtë seancë, cili nga subjektet ankuese nuk e ka dorëzuar akoma raportin financiar? Nga këta që janë këtu, nga subjektet ankuese, jo nga lista prej 106 partive.

Z.Y.Merkaj: Vetëm 3 subjekte, pas marrjes së gjobës kanë dorëzuar raportet financiare.

Z.I.Rusmali: Cilat?

Z.Y.Merkaj: Në datën 26.07.2021 e ka dorëzuar Partia Kombëtare Konservatore Albania, në datën 07.09.2021 ka dorëzuar raportin financiar Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar dhe po në datën 07.09.2021 ka dorëzuar raportin financiar Partia Ora e Shqipërisë.

Z.I.Rusmali: Pyetje tjetër për administratën përsëri. Nga subjektet ankuese cili prej tyre është përsëritës në mosrespektimin e kësaj dispozite të ligjit për partitë politike?

Z.Y.Merkaj: Këtë përgjigje nuk mund t'a jap për momentin. Do më duhet kohe, rreth 10 minuta që ta diskutoj.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

Z.I.Rusmali: Dakord, vetëm të lutem duhet të na e japësh. U tha këtu nga njëri nga subjektet që deri më sot nuk është aplikuar asnjëherë sanksion nga ana e KQZ-së për shkelje të dispozitës për afatin. Është e vërtetë?

Z.Y.Merkaj: Është e vërtetë që nuk është aplikuar.

Z.I.Rusmali: Pse nuk është aplikuar si sanksion, apo nuk keni dijeni?

Z.Y.Merkaj: Nuk kemi dijeni. Me krijimin e organeve të reja drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është parë ndoshta më me vëmendje ligji dhe është zbatuar.

Z.I.Rusmali: Ndoshta dhe një pyetje për Bindjen Demokratike, sepse ju ngrini tezën e ligjit që nuk ka parashikuar afat. Ju keni bërë ndonjëherë deklaram deri më sot, raportim?

Z.F.Halili, përfaqësues i BD-së: Po, kemi bërë.

Z.I.Rusmali: Për vitin e kaluar besoj.

Z.F.Halili, përfaqësues i BD-së: Po!

Z.I.Rusmali: Kur e keni bërë?

Z.F.Halili, përfaqësues i BD-së: Nuk e mbaj mend sepse unë jam...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

Z.I. Rusmali: Dakord, afatin ia vendosët vetë vetes apo jua kërkoi KQZ-ja që të bënit raportimin?

Z.F. Halili, përfaqësues i BD-së: Jo, ne afatin... Në fakt nga analiza që ne bëmë, ligji nuk e kishte përcaktuar një afat.

Z.I. Rusmali: Mirë dakord, analizën e lexova, unë dua vetëm këtë, si jeni udhëhequr një vit më përpara, për të bërë dorëzimin dhe si e parashikoni sot, sepse nuk e keni bërë akoma. Si e parashikoni sot, si e gjykoni sot juve, kur vepron, kur bie gongu për ju?

Z.F.Halili, përfaqësues i BD-së: Besoj se bie gongu brenda vitit pasardhës.

Z.I.Rusmali: Vitin 2021, kurdoqoftë, ju keni për ta dorëzuar, kjo është analiza juaj e kuadrit ligjor?

Z.F.Halili, përfaqësues i BD-së: Po!

Z.I.Rusmali: Dakord, nuk kam pyetje të tjera.

Z.E.Lako: Faleminderit zoti Rusmali! Zoti Braho!

Z.L.Braho: Unë kisha një kërkesë për administratën e KQZ-së, në qoftë se mund të ma vërë në dispozicion një model raporti financiar të një partie politike. Një nga këto që është depozituar së fundmi, për të parë dhe çfarë përmbajtje ka, sa voluminoze është.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

Z.E.Lako: Po zoti Çefa!

Z.E.Çefa: Faleminderit, edhe unë kam një pyetje për administratën. Nga përfaqësuesi i subjektit Partia e Minoritetit Etnik Grek u pretendua se është dërguar brenda limiteve të afatit. A është i vërtetë ky fakt? Ka ardhur dokumenti në KQZ apo jo?

Z.Y.Merkaj: Tani pasqyra financiare që është dorëzuar nga Partia e Minoritetit Etnik Grek, mban datën 02.04.2021. Por duke parë... jemi të gjithë juristë, si është parimi për komunikimin dhe njoftimin e vendimeve gjyqësore, na kanë sjellë dëftesën postare, që tregon që është depozituar në postën e Sarandës në datën 31 mars. Por, këtë e kemi marrë pasi kemi marrë vendimin e gjobës.

Përfaqësues të partive politike: Pa mikrofon, nuk dëgjohet.

Z.Y.Merkaj: Jo për Partinë e Minoritetit Etnik Grek jo, për ne është brenda afatit me dëftesën postare që kanë sjellë.

Z.E.Çefa: Dakord, në rregull. Faleminderit!

Z.E.Lako: Zoti Braho mbaruat apo po prisni raportin? Unë kam një pyetje për administratën. Vit pas viti çfarë praktike është ndjekur për dorëzimin e raporteve. Domethënë në rastet kur janë dorëzuar brenda afatit të konsideruar prej jush, që është 31 marsi, dhe në rastet kur nuk është sjellë raport fare, ka ndonjë evidencë, si është praktika në këtë drejtim?

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

Z.Y.Merkaj: Duke qenë se ligji për partitë politike, neni 23, nuk e ka pasqyruar afatin se kur dorëzohen pasqyrat financiare, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në vitin 2012 ka përcaktuar me një vendim të tijin afatin. Për analogji thotë tek arsyetimi i vendimit “Për analogji afati për dorëzimin e raporteve financiare vjetore për partitë politike do të jetë data 31 mars e çdo viti kalendarik”. Ky status normativ, i cili ka fuqi për të gjitha vitet, nuk është vetëm për vitin 2012.

Z.E.Lako: Vendimi që i referohesh?

Z.Y.Merkaj: Vendimi nr. 14, datë 23.12. 2012.

Z.E.Lako: I referohet vetem vitit 2012, sepse ky që kam unë përpara flet që pikës 1 i shtohet pika 01 me këtë përmbajtje “Partitë politike duhet të dorëzojnë pranë KQZ-së raportet financiare vjetore brenda datës 31.03.2012”.

Z.Y.Merkaj: Tek arsyetimi i vendimit më lart është shkruar, “ Për analogji afati për dorëzimin e raporteve financiare vjetore për partitë politike në KQZ do të jetë data 31 mars e çdo viti kalendarik”.

Z.E.Lako: Tek pjesa arsyetuese po i referoheni. Mirë dakord, kjo është çfarë thotë vendimi i KQZ-së, cila është praktika që ka ndjekur KQZ-ja? Ka kërkuar që të jenë brenda këtij afati, i ka pranuar edhe ato jashtë këtij afati dhe çfarë ka ndodhur me ato që nuk i kanë dorëzuar fare?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.09.09.2021

Z.Y.Merkaj: Pavarësisht se KQZ-ja ka marrë një vendim që ka përcaktuar afatin për dorëzimin e pasqyrave financiare të jetë 31 marsi i çdo viti kalendarik, në fakt edhe pas dorëzimit të tyre, ose edhe kur nuk e kanë dorëzuar fare, nuk ka marrë ndonjë masë gjatë viteve të kaluara.

Z.E.Lako: Domethënë mund të ketë subjekte politike që nuk kanë dorëzuar asnjëherë raport?

Z.Y.Merkaj: Po, mund të ketë.

Z.E.Lako: Po, zoti Rusmali.

Z.I.Rusmali: Praktika e akteve normative, me referencë date të saktë, si ky rast. Pra, krijohet një rregull, por thuhet për zgjedhjet e vitit 2012. Ka qenë e përhapur dhe në fusha të tjera në kuadrin rregullator të KQZ-së? Ka patur raste të tjera që akte që kanë qenë të përcaktuara me datë, nuk i keni zbatuar, pavarësisht nga data edhe më pas?

Z.Y.Merkaj: Nuk e kuptova. Ligji për partitë politike nuk e ka të përcaktuar datën.

Z.I.Rusmali: Nuk po them për ligjin për partitë politike. KQZ-ja ka nxjerrë një akt me karakter normativ, vendimi nr. 14 i vitit 2012, i cili vendos rregullat për zgjedhjet e kujt viti, 2012, 2013?

Z.Y. Merkaj: Pa mikrofon, nuk dëgjohet.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

Z.I.Rusmali: Ky është për vitin kalendarik, dakord. Pra, vendos rregullin për vitin 2012. Tani në praktikën e KQZ-së, ka patur raste të tjera ku nxirreshin akte me karakter normativ? Thuhej për zgjedhjet e vitit 2013 dhe ky akt pastaj zbatohet dhe në vitin 2015, vitin 2017, pavarësisht se kishte datë?

Z.Y.Merkaj: Po, ka akte. Ka raste, jo për dorëzimin e pasqyrave financiare, por akte të tjerë po. Është e përcaktuar edhe në Kodin Zgjedhor që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si organ kolegjal, mund të caktojë akte me karakter normativ që përdoren për çdo rast zgjedhjeje.

Z.L.Braho: Si e kuptoj unë këtë vendim të KQZ-së, sepse dispozita në lidhje me bilancin e partive politike është ndryshuar në vitin 2011 në ligjin për partitë politike. Ndryshimi është bërë, përpara pikës 1 shtohet pika 01 me këtë përmbajtje “Partitë politike duhet të dorëzojnë pranë KQZ-së raportet financiare vjetore brenda datës 31.03.2012”. Pra bëhet fjalë për vitin 2011. Për vitin 2011 do të jetë 31.03.2012. Në përmbajtje është 31 mars i çdo viti. Pra është bërë pas ndryshimit të ligjit.

Z.Y.Merkaj: Po patjetër është bërë pas ndryshimit të ligjit. Pasi në pikën 3 të nenit 23, organi kompetent për të përcaktuar afatin është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. E ka autorizuar ligji Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të përcaktojë afatin për dorëzimin e pasqyrave financiare. Gjithashtu për vendimin nr. 14, duhet të jetë një lapsus 2012-ta, sepse vendimi është marrë në nëntor të vitit 2012. Në pikën 1 thotë 31 mars 2012, nuk ka shumë logjikë. Duhet të jetë 31 marsi i çdo viti kalendarik, sepse nuk mund të parashikojë që 6 muaj para të dorëzohen raportet financiare.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

Z.L.Braho: Ka qenë lapsus që është tek data e vendimit apo tek dispozitivi?

Z.Y.Merkaj: Tek data në fund duhet të jetë 31 mars i çdo viti kalendarik.

Z.L.Braho: Dakord!

Z.E.Lako: Atëherë, gjithë logjika është që, dhe vendimmarrjet që ka marrë KQZ-ja, në atë kohë i është referuar legjislacionit tatimor për afatet për dorëzimin e tyre pasqyrave. Unë kam një pyetje për subjektet ankuese, mund të përgjigjeni secili, mund të përgjigjet dikush nga ju. Shumica prej jush, ju referuat që pandemia ka ndikuar në vonesat apo në mosdorëzimin e këtij raporti. Unë do të doja shkurtimisht nga gjithsecili ose një përfaqësues prej jush, meqë për ata që kishin një logjikë, që në ç' mënyrë ka ndikuar pandemia në dorëzimin e raportit? Cila është mënyra, pse ka ndikuar pandemia në dorëzimin e raportit dhe duke iu referuar asaj që disa prej jush thatë që, vjet janë dorëzuar, ka ndryshuar afati i dorëzimit të pasyrave financiare, referuar dhe legjislacionit tatimor, ka që në shtator, kjo gjë ka ndodhur dhe këtë vit apo jo? Pra, keni dorëzuar raportet në institucionet tatimore, është shtyrë ky afat, për t'iu referuar dhe kësaj që deklaruat këtu para KQZ-së? Kush të dojë mund të flasë. Po, zoti Gjuzi!

Z.K.Gjuzi, përfaqësues i PKKA-së: Faleminderit zoti kryetar! Në radhë të parë, në praktikën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është komunikimi nëpërmjet partive politike përmes shkresave. Në lidhje me këtë vit që flasim ne nuk kemi patur një shkresë të drejtpërdrejtë si herët e tjera. Në praktikën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Partia Kombëtare Konservatore Albania, në të gjitha rastet e ka

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

paraqitur bilancin edhe në organin tatimor, edhe këtu. Në fakt, nuk dua ta them por, edhe këtu unë e kam paraqitur atë ditë, por defekti ishte i personit që e ka paraqitur, që nuk ka marrë dokumentin me vete. Pra mund të jetë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mund të jetë po të kontrollohet arkiva, kjo është shumë e vështirë për t'u gjetur dhe në këtë kuptim unë do desha mirëkuptimin tuaj, në të dy rastet, pra, ta gjykoni që, të paktën 20 subjektet politike që janë këtu, janë subjektet që kanë një lloj përgjegjshmërie në lidhje me legjislacionin shqiptar. Administrata ka qenë tejte e ngarkuar kuptohet, se ishte vit zgjedhor. Në këtë kontekst ka shpëtuar ajo që ne e quajmë njoftimi zyrtar, që na vjen ne, dhe ne e paraqesim bilancin. Përballë jush do të kërkoja që, meqenëse në disa raste domethënë, ato kërkesat tona janë anuluar ose janë parë me një këndvështrim tjetër, të paktën në marrëdhëniet financiare, kur nuk ka dëm buxheti i shtetit, të jetë parasysh dhe kjo masë administrative, le të vlejë për ne si pjesë morale se ne kemi marrë dëm moral këtu, dhe këtë e kam me sekretarin e Përgjithshëm, në këtë moment, për arsye të lapsusit që është deklaruar në media, që gjobiten partitë politike me 10 milionë lekë. 10 milionë lekë domethënë, në kuptimin 1 milion lekë të reja janë një shumë e madhe sa dhe të tjerët që na votojnë ne ose janë përkrahësit tanë thonë, çfarë bëhet kështu, sa para më fshehin këta?! Në fakt ne nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve marrim zero buxhet, zero buxhet. Kjo edhe për arsye të marrëveshjeve në prapaskenë të partive që konsiderohen, të partive administrative më të mëdha në vend, ato që kontrollojnë prej 30 vjetësh këtë vend dhe prandaj jemi në këtë gjendje. Nëse do të kishte një lloj barazie zgjedhore, qoftë tek sistemi financiar, qoftë tek kontrolli i votës, nuk do të ishim në prokurori, nuk do të ishim sot, ju theksoj, jemi në gjykatën administrative në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për mosmarrjen e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për votimin e emigrantëve, pra trysnia që ushtruan 3 partitë e tjera bëri që emigrantët nuk votuan.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

Që do të thotë, ligji paska hapësirë për partitë që konsiderohen në mënyrë administrative të mëdha, ata që braktisën parlamentin në momente të caktuara, ne që jemi seriozë, në një moment lapsusi, është lapsus, nuk themi, nuk jemi ne në shkelje, por duhen marrë parasysh këta faktorë, pandemia e njohur botërisht, momenti zgjedhor, edhe për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve duhet marrë parasysh, kjo është trysni e jashtëzakonshme. Faleminderit zoti kryetar!
Faleminderit të nderuar gjyqtarë të kolegjit!

Përfaqësuesi i ADK-së: Desha të shtoja një pikë pasi kemi një vendim nr.258, datë 21.04.2021 të KQZ-së, në të cilin ndër të tjera shprehet:”Të shtyjë afatin e auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike, gjatë vitit kalendarik 2020. Auditimi i fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit 2020 do të kryhet gjatë muajit shtator 2021. Ndërsa KQZ-ja me anë të vendimit nr.430, datë 22.07 i bie që të bjerë në kundërshtim me këtë vendim, që i përket muajit prill, datë 21, lidhur me gjobën që ka vendosur. Pastaj pika tjetër ka të bëjë edhe ligji i vitit 2012 lidhur me këta, nuk është shumë e qartë pasi me sa shikohet i përket vetëm atij vitit 2012. Këto janë akte që janë kryer, domethënë, nuk janë shumë të qarta, lidhen edhe me zbatimin e tyre. Ndërsa pika tjetër ka të bëjë me, lidhur me bilancin, pothuajse mund të flasim për partinë tonë, bilanci është zero pothuajse. Se po të kishim pasur para e bilance do të ishim në parlament, nuk ka sjellë asnjë lloj pasoje, asnjë penalitet administrativ dhe si e tillë do dëshiroja të krijohen praktika të tjera, më qartë, në kuptim të ligjit, jo se nxjerrin praktika KQZ-ja dhe janë partitë e vogla, që kanë hyrë në parlament dhe të goditen, në kuptimin aq sa është lënë mundësia penaliteti administrativ. Faleminderit!

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

Z.L.Braho: Të gjithë po pretendoni se nuk i keni shkaktuar asnjë dëm buxhetit të shtetit. Tani në qoftë se nuk depozitohen bilancet, si mund të arrijmë në përfundimin që i është shkaktuar apo jo dëm buxhetit të shtetit? Pra në qoftë se mund të na e sqaroni këtë?

Përfaqësuesi i ADK-së: Po, ne lidhemi me shkakun objektiv, arsyen objektive që ka të bëjë edhe paqartësia siç e lanë e vitit 2012 dhe shkakun objektiv tjetër është edhe pandemia, në kuptimin a do mbyllen apo s' do mbyllen, kjo është. As vetë ligji më i madh i botës që mund të jetë ose i shtetit nuk e di se çfarë do ndodhë, se nuk varet nga njerëzimi, as nga ligji. Pastaj ndryshe është një pasojë juridike që mund të jetë e riparueshme, ndryshe diçka që ndodhi në këtë moment, kush ka depozitime mund t'i kryejë, dhe etika më kryesore që gjithë filozofia parashikon se ligjet ndryshojnë sipas shoqërisë, pra po marrim sensin konkret, se 20 parti këtu edhe një ndryshim, në kuptim po u shkel ligji, do të detyrojmë, në kuptimin ndryshimin e këtyre vendimeve, që të fillohet diçka dhe të bëhet diçka që mos të falen pastaj, duke patur parasysh që janë 20 parti, 20 parti i bie që është një popullate e tërë.

Z.L.Braho: Me këtë logjikë në qoftë se 20 parti nuk depozitojnë asnjëherë bilancet, nuk duhet të depozitohen më bilancet.

Përfaqësuesi i ADK-së: Më falni, zoti anëtar unë ju shpjegova. Unë flas është një moment duke patur arsyet edhe ligjore edhe objektive, në kuptime të pavarura edhe nga vetë ligji, siç është pandemia.

Z. Y.Valteri, përfaqësues i PBD-së: Për të sqaruar pak, megjithëse këto që tha parafolësi unë nuk e di këtë vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

2021, sa për vitin 2019, shtyrja e afatit për dorëzimin e pasqyrave financiare deri më 30 shtator, ka vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, se na ka ardhur me shkresë, atëherë unë bëj një pyetje për sekretarin, pse ne vjet i kemi dorëzuar më 30 shtator? Unë vjet e kam dorëzuar më 7 shtator pasqyrën financiare.

Z.E.Lako: Atë pyetje e sqaruar me administratën dhe në gjithë këto vite nuk është marrë asnjë sanksion, u referua nga administrata, është për herë të parë që merret, pavarësisht se disa subjekte e kanë dorëzuar brenda afatit që është kërkuar nga KQZ-ja, por disa subjekte nuk e kanë dorëzuar fare. Pyetja ime tani konsistoi që, si ka ndikuar pandemia tek ju në mosdorëzimin e raportit. Kjo ishte pyetja, dhe a ka ndonjë referim tek legjislacioni tatimor për këtë vit, që siç mund të jenë shtyrë dorëzimet e bilanceve apo jo, janë të shtyrë edhe këtu në KQZ. A ka ndonjë referim? Këto ishin dy pyetjet.

Z. Y. Valteri, përfaqësues i PBD-së: Unë e referova dhe në fjalën time, ne e dinim që dhe sivjet është më 30 shtator, sivjet nuk ka pas ndonjë komunikim me ndonjë shkresë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që shtyhen afatet për dorëzimin e pasqyrave financiare, unë e thashë, por ne kujtuam se do ishte 30 shtatori dhe sivjet. Pastaj nuk është se po i fshihemi, ne i kemi dorëzuar, ja unë e kam dorëzuar pasqyrën financiare. Nëse ne themi që nuk i dorëzojmë pasqyrat financiare, prandaj kam kërkuar mirëkuptimin tuaj që këtë vit të na falet kjo gjobë.

Z.E.Lako: E qartë! Ka ndonjë koment tjetër nga ndonjë përfaqësues i ndonjë subjekti tjetër? Po zoti Gjuzi!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

Z.K.Gjuzi: Zotëria bëri pyetjen që ku e dini ju që bilanci nuk dëmton buxhetin e shtetit, apo jo, kjo ishte pyetja? Teorikisht ju keni të drejtë, unë jam ekonomist me profesion, por nëse praktika aty për subjektet që ne po flasim është me zero, atëherë kjo praktikë ka vazhduar dhe e keni përpara besoj që të paktën Partia Kombëtare Konservatore ka dorëzuar me zero, pra në këtë rast është nul dëmi në buxhetin e shtetit, nuk e di a jam i qartë me një përgjigje që ju dhashë, faleminderit!

Z.E.Lako: Faleminderit zoti Gjuzi, nëse s'ka ndonjë koment tjetër? Po zoti sekretar i Përgjithshëm!

Z.Y.Merkaj: Desha të sqaroja këtë shkresën që ka dorëzuar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, u ka drejtuar partive politike. Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mban datën 21 prill 2021 dhe ka të bëjë me auditimin e fondeve të partive politike, jo me dorëzimin e pasqyrave financiare. Unë kam bërë një kopje, po jua shpërndaj, të vendimit.

Z.E.Lako: Është e qartë, po! Atëherë, shkurtimisht, çdo subjekt ankues sipas radhës, çfarë kërkoni nga Komisioni? Shkurtimisht me dy fjalë.

Përfaqësuesi i ADK-së: Kërkojmë ndryshimin e vendimit dhe heqjen e gjobës

Z.E.Lako: Kjo është çfarë kërkoni të gjithë nga Komisioni?

Përfaqësuesit e partive njëzëri: Po!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

Z.E.Lako: Faleminderit! Atëherë Komisioni do të tërhiqet për vendim, besoj për rreth 30 minuta dhe do t'ju thërrasim përsëri, rreth orës 11:30. Faleminderit!

Rifillon Mbledhja

Ora 12:13

Z.E.Lako: Atëherë, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosi:

1. Ndryshimin e vendimit nr.430, datë 22.07.2021 për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të partive politike, për vitin kalendarik 2020, si dhe sanksionet për mosdorëzimin e tyre të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Pranimin e kërkesave ankimore të subjektit zgjedhor Partia e Minoritetit Etnik Grek për të Ardhmen dhe heqjen e sanksioneve administrative pasi i ka dorëzuar pasqyrat financiare brenda afatit.
3. Pranimin e kërkesës ankimore të subjektit Partia Lëvizja Demokratike e Shqipërisë dhe heqjen e sanksioneve administrative, pasi siç ka rezultuar nuk ka patur veprimtari fiskale për vitin 2020.
4. Pranimin pjesërisht të kërkesave ankimore të subjekteve Partia Kombëtare Konservatore Albania, Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar dhe Partia Ora e Shqipërisë dhe vendosi në sanksionet administrative, në shumën 50 mijë lekë, për arsye sepse gjatë kësaj periudhe janë vënë në lëvizje dhe kanë dorëzuar raportin.
5. Rrëzimin e kërkesës së subjektit zgjedhor Partia Lëvizja e Legalitetit, Partia e Gjellbër dhe lënia në fuqi të sanksionit administrativ në shumën 50 mijë lekë.
6. Ndryshimi pjesërisht i vendimit nr.430, datë 22.07.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për subjektet:

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.09.09.2021*

Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë,

Partia Balli Kombëtar,

Partia Balli Kombëtar Demokrat,

Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve,

Partia Demokracia e Re Europiane,

Partia Emigracioni Shqiptar,

Partia Aleanca Maqedonasve për Integrimin Europian,

Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim,

Partia Demokratike e Bashkimit Mysliman Shqiptar,

Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar,

Partia Bindja Demokratike,

Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë dhe Partia Uniteti Kombëtar, dhe vendosjen e sanksionit administrativ në shumën 65 mijë lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e tij. Faleminderit!

Vendimin e zbardhur do ta merrni brenda një afati shumë të shpejtë.

Vendimi nr. 111

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

